



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

## V E N D I M

Nr. 17, datë 01.03.2021

### **“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE TË REJA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 6”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, vendimit nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative nr. 6, zona Kombinat, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”, vendimit nr. 172, datë 21.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”, të ndryshuar, urdhrit nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit nr. 9374 prot., datë 1.3.2021 të Komisionit të Posaçëm, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### **V E N D O S I :**

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për subjektet përfituese nga programet e rindërtimit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e listës të subjekteve përfituese nga programi i zhvillimit të objekteve të reja në Njësinë Administrative nr. 6, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale njofton menjëherë Njësinë Administrative nr. 6, për nënshkrimin e marrëveshjes paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë, për përfituesit e parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi.
4. Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigjojë gabimet në rast se evidentohen në listat e përfituesve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të këshillit bashkiak që kanë për objekt shpalljen e listave fituese nga programet e rindërtimit. Korrigjimet i paraqiten këshillit bashkiak për miratim.
5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.
6. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësisve Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike

e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Njësia Administrative nr. 6, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**ROMINA KUKO**